



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02.Nr. 8108/2020

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës dhe nenin 58 dhe në bazë të Statutit të Komunës neni 43, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M

PËR PAGESËN E PRAKTIKANTËVE

1. Merret vendim për pagesën e dhjetë (10) praktikanëve, në shumë prej 100 € (njëqind euro) për secilin praktikant për periudhën gjashtë mujore duke filluar nga data 01.11.2020 - 30.04.2021.
2. Shuma e pagesës e cila do të kryhet për dhjetë praktikantë është prej 1000 € (njëmij euro), për muaj, ndërsa për periudhën gjashtë mujore në shumë prej 6000 € (gjashtëmij euro, e cila do të filloj nga 01.11.2020.
3. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe ekzekutohet nga drejtoria për buxhet dhe financa.
4. Me këtë vendim njoftohen: Praktikantët, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Arsyetim

Duke pasur parasysh se praktikantët do të kryejnë praktikë në komunën e Hanit të Elezit dhe me punën e tyre do të ndihmojnë në aktivitete dhe punë të ndryshme sipas kordinimit të detyrave nga ana e të punësuarve në administratën e komunës, pasi që shumë e pagesës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është 170 euro, kemi parë të arsyeshme që të kompensohen edhe me nga 100 euro nga ana e komunës për secilin praktikant, në mënyrë që në punët e tyre të ndihen më aktiv dhe kjo ndikojë në motivimin e tyre për punë.

Data: 02.11.2020
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës
Rufki Suma